

Njoftim për shtyp 10 Shtator 2020 , mbi ceremoninë e betimit të tetë (8) anëtarëve të rinj të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor

Sot me datë 10.09.2020, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, u organizua ceremonia e betimit të tetë (8) anëtarëve të rinj të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, përzgjedhur nga shorti publik i datës 8 shtator 2020.

Në fjalën e saj përshëndetëse znj. Naureda Llagami, Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndër të tjera shprehu rëndësinë që ka krijimi i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, pasi trupa e gjyqtareve të përzgjedhur kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, duke garantuar integritet të lartë moral dhe etik.

Më tej znj. Llagami shprehu bindjen se aftësia profesionale dhe besueshmëria e trupës gjyqësore të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, do të përmbushin pritshmëritë e shoqërisë shqiptare për garantimin e një procesi zgjedhor të lirë, të barabartë, të rregullt dhe të ndershëm.

Duke u ndalur tek sfidat e anëtarëve të rinj të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe transparenca me të cilën u karakterizua përzgjedhja e tyre, znj. Llagami u shpreh se kjo trupë gjyqësore do të kontribuojë në konsolidimin e sistemit demokratik, sundimin e ligjit dhe të ardhmes evropiane të vendit tonë.

Më pas u vijua me betimin e gjyqtarëve:

- znj. Manjola Xhaxho
- z. Gentian Medja
- z. Sokol Ibi
- znj. Alma Kolgjoka
- znj. Emona Muçi
- znj. Esmeralda Çeka (Xhili)
- z. Asim Vokshi
- znj. Edlira Petri